Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 972/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e Shkëndije Halimi, anëtare për Kuvendin Komunal në Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Shkëndije Halimi, anëtare për Kuvendin Komunal në Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Mitrovicë, me shenjën ZL.Anr.972/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.972/2017 me datën 10.11.2017, nga Shkëndije Halimi, anëtare për Kuvendin Komunal në Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Mitrovicë në të cilën pretendon se i mungojnë votat e saja në vendvotimet 1104b/04R; 1102b; 1102x; 1103b; 1106b.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se parashtruesja në apel me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e saja. Prandaj, Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.972/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani

Udhëzim Juridike:
PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*